



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2, pika c dhe nenit 40, pika 40.2, shkronja a të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane dhe të dispozitave të nenit 34, pika 34.1, shkronja c e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, më 21.09.2022, miratoi këtë

RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE
BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET
URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
NR. 01-030/01-0134831/18, DT. 06.06.2018

Neni I

Ndryshohet dhe riformulohet neni 4, paragrafi 4.1 i rregullores bazike, me tekstin si në vijim:

4.1. Kuvendi i Komunës emëron një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në zgjedhjen e këshillave lokalë. Komisioni duhet të ketë 7 anëtarë, katër (4) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjektet me përfaqësim më të madh, një (1) anëtar nga ekzekutivi, një (1) anëtar nga Shoqëria civile dhe një (1) përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagja urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal. Nëse këshilli zgjidhet në fshat ose lagje urbane ku shumica e popullatës është nga pakicat, atëherë përfaqësuesi duhet të jetë nga komuniteti pakicë.

Nga 7 anëtarët e komisionit 3 (tri) duhet të jenë femra, si dhe 1 anëtar ose anëtare patjetër të jetë e komunitetit jo shumicë. Përbërja e komisionit duhet të përfaqësoj përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës.

Kryesuesi i komisionit zgjidhet nga anëtarët e komisionit.

Së paku katër (4) anëtarë të komisionit të Komunës duhet të jenë të pranishëm në të gjitha tubimet zgjedhore që organizohen për zgjedhjen e këshillave lokalë.

Neni II

Ndryshohet dhe riformulohet neni 5, paragrafët 5.12 dhe 5.13 të Rregullores bazike, me tekstin si në vijim:

6.1. Në rastet kur qytetarët konsiderojnë se anëtarët, ose kryetari i këshillit lokal, nuk i kanë përmbushur obligimet që dalin nga kjo rregullore, anëtarët dhe kryetari i këshillit lokal mund të shkarkohen me shumicë të votave të banorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane me rastin e tubimit publik me qytetarë. E njëjta procedurë vlen edhe në rast se shkarkohet ose dorëhiqet vetëm një anëtar.

6.2 Komisioni që udhëheq zgjedhjet nëpër këshilla ka mandat të lidhur me mandatin e Kuvendit komunal.

5.12. Anëtarët dhe kryetarët e këshillave lokalë të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, zgjidhen me mandat 4-vjeçar.

5.13. Tubimet e kanë legjitimitetin juridik, nëse në tubime janë të pranishëm së paku 20 pjesëmarrës me të drejtë vote të atij lokaliteti. Përfaqësimi në këshillat lokalë duhet të reflektoj përfaqësimin gjinor dhe etnik.

Neni III

Ndryshohet dhe riformulohet neni 13 i Rregullores me tekstin dhe paragrafët e ri, si në vijim:

13.1. Për punën e tyre kryetarët e këshillave lokalë kompensohen nga buxheti i komunës përkatëse.

13.2. Kompensimi për kryetarët e këshillave lokalë bëhet në shumën ekuivalente të anëtarëve të komiteteve obliguese.

13.3. Kompensimi për pjesëmarrjen në takime bëhet vetëm për gjashtë (6) takime të këshillit lokal të mbajtura brenda vitit kalendarik.



Neni IV

Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës dhe drejtoritë e tjera relevante.

Neni V

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-110/05-206977/22, më 26.09.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

